

Almut Cobet
Erste Bürgermeisterin
Hauptstr. 1
73033 Göppingen

Letër informimi lidhur me testin e detyrueshëm, që do të zhvillohet vetëm një herë në kopshtet e fëmijëve në Göppingen, pas pushimeve verore

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Gëzon fakti që shkalla e incidencës në Göppingen për disa javë me radhë është shumë e ulët. Veçanërisht na gëzon fakti që jemi në sezonin e verës, në kohë pushimesh dhe që përsëri është mundësuar dhe lehtësuar udhëtimi jashtë vendit. Ju dëshirojmë ditë vere të këndshme dhe të relaksuara dhe mezi presim t'u dëshirojmë mirëseardhje fëmijëve tuaj, në qendrat e fëmijëve dhe me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor!

Për të kontrolluar në mënyrën më të mirë procesin e përhapjes së infeksionit edhe pas hapjes së kopshteve të fëmijëve, do të zbatohet detyrimi i testimit të fëmijëve lidhur me korona-virusin. Kjo nënkupton që për të gjithë fëmijët, para se të futen në ambientet e kopshtit, detyrimisht duhet paraqitur rezultati negativ i testit të shpejtë të korona-virusit. Kjo gjë vlen vetëm për ditën e parë pas pushimeve, që fëmijëve t'u mundësohet të qëndrojnë në kopsht. Teste shtesë dhe të detyrueshme për fëmijët nuk janë planifikuar.

Ky detyrim mund të përmbushet edhe me prezantimin e certifikatës përkatëse lidhur me rezultatin negativ të testit, që nuk mund të jetë më i vjetër se 48 orë (në rastet kur testi do të bëhet në një qendër testimi zyrtare, mjek ose farmaci).

Datum:
23.08.2021
Bearbeiter:
Sandra Corveleyn
Aktenzeichen:
104/Cor
Telefon:
07161 650-0
Durchwahl:
2820
Telefax:
07161 650-48 2820
E-Mail:
SCorveleyn@goeppingen.de
Internet:
<http://www.goeppingen.de>



Unsere Öffnungszeiten:
Mo: 08:00 – 13:00 Uhr
Di, Mi, Fr,: 08:00 – 12:00 Uhr
Do: 13:30 – 18:00 Uhr

Për fat të keq, testet alternative dhe të shpejta për zbulimin e korona-virusit që do të bëhen në kopshtet ose në shtëpi nuk do të pranohen.

Ju lutemi të keni mirëkuptim lidhur me këtë masë të nevojshme, me qëllim që të mbroni më mirë vetveten dhe të tjerët.

Me respekt

A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized 'A' followed by a cursive 'C' and 'B'.

Almut Cobet